



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:014765

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05623443

KPPP.nr.84/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo” J.S.C., me seli në Prishtinë, Rr. “Robert Doll”, nr.99, ndaj debitorëve 1. “Mahagoni” me seli në Podujevë, me adresë në fshatin Sveqel, me përfaqësues I.H. dhe garantuesit 2. S.H. me adresë në fshatin, Komuna e Podujevës, duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve të ushtruar kundër - Konkluzionit Njoftues E.nr.82/07 të datës 24.10.2023, të nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, me datë 25.04.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i palejuar prapësimi i debitorit “Mahagoni”, me përfaqësues I.H. dhe garantuesit S.H. i paraqitur kundër Konkluzionit Njoftues E.nr.82/07 të datës 24.10.2023 të nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë.

A r s y e t i m

Duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo” J.S.C. Gjykata Themelore në Podujevë fillimisht kishte lëshuar Aktvendimit 82/07 të datës 28.03.2007, ku më pas lënda ishte bartur përmes Konkluzionit Njoftues E.nr.82/07 të datës 24.10.2023 tek Përmbaruesi Privat Saranda Rexhepi me seli të zyrës në Prishtinë, lidhur me lejimin e përmbarimit në bazë të Marrëveshjes mbi Kredinë Nr.11447 dhe Linjës së Kredisë Nr.11148 dhe vërtetimit të regjistrimit të pengut në Zyrën e Pengut, në lidhje me borxhin e papaguar të kredisë në lartësi prej 19,339.77€ (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent).

Debitori ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarimit me pretendimin se Konkluzioni Njoftues E.nr.738/23 i datës 31.10.2023, është nxjerr në

kundërshtim me dispozitat ligjore. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të anuloj propozimin e debitorit si të pabazuar.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit me arsyetimin se i njëjti nuk është i ligjshëm për shkak se është paraqitur ndaj konkluzionit, respektivisht Konkluzionit Njoftues E.nr.82/07 të datës 24.10.2023 të nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë.

Lidhur me këtë rast Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, përmes Aktvendimit 82/07 të datës 28.03.2007, kishte caktuar ekzekutimin e propozuar sipas Propozimit për përmbarim të paraqitur nga kreditori më 22.11.2006, për përmbarimin në bazë të Marrëveshjes mbi Kredinë Nr.11447 dhe Linjës së Kredisë Nr.11148 dhe vërtetimit të regjistrimit të pengut në Zyrën e Pengut, në lidhje me borxhin e papaguar të kredisë në lartësi prej 19,339.77€ (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent).

Kjo lëndë më datën 31.10.2023 përmes Konkluzionit Njoftues E.nr.82/07 të datës 24.10.2023 të nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, ishte bartur tek Përmbaruesi Privat, Saranda Rexhepi, e cila këtë konkluzion sipas fletë kthesave të datës 13.11.2023 dhe 27.12.2023 i kishte përcjell tek kreditori dhe debitori.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 3 par. 5 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore të ndryshuar dhe plotësuar me nenin 3 par. 6 të Ligjit Nr. 05/L-118 gjeti se prapësimi i debitorit është i palejuar, andaj të njëjtin e hodhi poshtë si të palejuar për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë më 31.10.2023 përmes Konkluzionit Njoftues E.nr.82/07 të datës 24.10.2023, kishte bartur tek Përmbaruesi Privat, Saranda Rexhepi, lëndën përmbarimore sipas propozimit kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo” J.S.C.

Gjykata iu referua nenit 3, par 5 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, ku përcaktohet se: “5. Konkluzioni nxirret për zbatimin e disa veprimeve dhe për drejtimin e procedurës.”. Ndërkaq me nenin 3 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se: “3 Neni 3 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohet paragrafi i ri 6., me tekstin si vijon: 6. Kundër konkluzionit nga paragrafi 5. i nenit 3 të ligjit nuk është i lejuar mjeti juridik. Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të

këtij Aktvendimi, duke hedhur prapësimin si të palejuar pasi që i njëjti është ushtruar ndaj konkluzionit dhe jo ndaj urdhrit përmbartimor.

Andaj, në kuptim të dispozitave të lartcekura, gjykata vlerëson se ndaj Konkluzionit Njoftues E.nr.82/07 të datës 24.10.2023 të nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, nuk është lejuar mjete juridik, respektivisht prapësimi i debitorit nuk është i lejuar.

Pretendimet lidhur me lejueshmërinë e Aktvendimit 82/07 të datës 28.03.2007, gjykata nuk i shqyrtoi për shkak se prapësimi është paraqitur ndaj konkluzionit të datës 24.10.2023.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 73, paragrafi 1 dhe 3 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.84/24, datë 25.04.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.